



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 788, Datë 01.04.2021

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z. Eduard YPI	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.04.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, formulari i njoftimit të përqendrimit dhe Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

**VËREN SE :**

**Transaksioni dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me përfimin e kontrollit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

*Pala blerëse:* Intesa Sanpaolo Vita S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionin italian, me objekt veprimtarie: ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve dhe

risigurimeve në fushën e jetës, aksidenteve dhe degët e sigurimeve shëndetësore. Intesa Sanpaolo Vita S.p.A kontrollohet nga Grupi Intesa Sanpaolo. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

*Pala shitëse:* BNP Paribas Cardif S.A., është një shoqëri franceze. BNP Paribas Cardif S.A zotëron 100% shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A.

*Shoqëria Target:* Cargeas Assicurazioni S.p.A., është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian. Cargeas është aktive në tregun e sigurimit të jo-jetës në Itali.

Cargeas Assicurazioni S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Më datë 20 Shkurt 2021 palët kanë konfirmuar dhe nënshkruar Propozimin e Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve nga dhe ndërmjet BNP Paribas Cardif S.A. dhe Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.

Në datën e kësaj Marrëveshjeje shitësi BNP Paribas Cardif S.A zotëronte 63,100,000 aksione të zakonshme të targetit Cargeas Assicurazioni S.p.A, të cilat përfaqësojnë kolektivisht 100% të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, blerësi Intesa Sanpaolo Vita S.p.A do të blejë nga shitësi BNP Paribas Cardif S.A. të gjitha kuotat e zotëruara tek shoqëria target Cargeas Assicurazioni S.p.A.

Kontrolli i qëndrueshëm mbi shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A., është përfundimi i kontrollit të vetëm nga Intesa Sanpaolo Vita S.p.A mbi shoqërinë Cargeas Assicurazioni S.p.A. Transaksioni plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10, pika 1 germa b të Ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Referuar pasqyrave financiare të palëve në marrëveshje, transaksioni plotëson edhe kriteret e përcaktuara në nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si i tillë kërkohet autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Vlerësimi i konkurrencës**

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës” treg përkatës mund të konsiderohet tregu i sigurimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në tregun shqiptar, përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim dhe nuk do të ketë asnjë ndikim në Shqipëri.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të shoqërisë Cargeas Assicurazioni S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo Vita S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**